



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.19

Prishtinë, më 19.3.2018, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla – N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Mungoi: Glauk Konjufca.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Florian Syla dhe Valbona Bytyçi, Ekonomia Online; Mejreme Tahirukaj, Radio Kosova; Ismail Shabani, Kosova Press; Edita Kusari dhe Shaban Murturi, EUSR/EUO; Gzim Shala, IKD/BPD; Blerta Bejtullahu EUSR/EV Office dhe Albert Krasniqi KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion;

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
6. Shqyrtimi i Mocionit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Hajdar Beqa propozoi që pika 6 e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e mocionit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, të hiqet nga rendi i ditës pasi që mocioni duhet të përmbajë arsyetim më të hollësishëm dhe rekomandim të qartë për komisionin.

Kundër këtij propozimi ishte Albulena Haxhiu pasi që siç theksoi ajo edhe po të mos kishte shkresë për shkelje do të duhej që si komision të kujdesemi që kur ka shkelje të rregullores të reagojmë dhe konstatojmë shkeljet eventuale.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e shqyrtoj Projektligjin e theksuara dhe vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni me shumicë votash nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr. 06/L-061 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat

Kryetarja paraqiti për shqyrtim për Gjykatat dhe paraqiti vërejtje në neni 33 lidhur me heqjen e kufizimeve të gjyqtarëve jashtë orarit të punës që ka qenë 25 % vetëm me leje të këshillit gjyqësor. Vërejtje paraqiti edhe te themelimi i degëve të gjykatave pasi që, siç tha ajo, është e pa drejtë që nuk kemi degë edhe te Hani Elezit.

Pas diskutimeve, komisioni me shumicë votash nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-054 për Gjykatat

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion

Kryetarja paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike

Kryetarja paraqiti para Komisionit Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Të ndryshme

Kryetarja kërkoi nga kryesuesit e grupeve punuese që të përshpejtojnë aktivitetet e grupeve punuese pasi që si komision kemi shumë projektligje në procedurë dhe duhet të procedojmë më shpejt.

Komisioni vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat të formojë Grupin e punës në përbërje: Korab Sejdiu, kryesues, Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Shkumbin Demaliaj dhe Sami Kurteshi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu